Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-241
Datë 08.05.2018

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 25.04.2018, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Validohet dhe akreditohet "RIT KOSOVO"- (AUK), në Prishtinë, adresa Kampusi Gërmia, Rruga Dr. Shpëtim Robaj p.n., për periudhën 06.02.2018 deri 06.02.2021 me kualifikimin:

   1.1. Profesionistët /specialistët e administrimit të politikave, Niveli V sipas KKK me 13 kredi të AAP.

   Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

   - Programi për zhvillim të politikave publike dhe lidership (PPDL) dhe zhvilluesi i këtij programi "RIT Kosovo" (më tutje AUK) me rastin e përcaktimit të hyrjes së kandidatëve në këtë program, në marrëveshje me institucionet që përfitojnë nga programi PPDL, duhet ta përcaktojë qartësisht që institucionet që përfitojnë nga programi, në kohën e zhvillimit të programit të lirohen nga të gjitha obligimet e punës dhe funksionet që ushtrojnë, ndërsa dita që zhvillojnë programin të llogaritet si ditë e punës. Në këtë aspekt, AUK duhet të hartoj kritere përjashtuese nëse nuk respektohet ky kriter.

   (Afati kohor: 30. 04. 2018)

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara, të cilat, janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucion ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në diapozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- American College in Kosovo Foundation në Prishtinë
- AKK

Kryetari i KD së AKK-së
Bedri Xhafa